



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera – Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve – Kancelarija za pitanja zajednica – Office for Community Affairs

Ftesë për Propozime

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë - ACN

I. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj ftese për propozime është që të bëj thirrje për kërkesa nga komunat për financimin e projekteve që korrespondojnë me misionin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve/Zyrën e Kryeministrit (ZÇK-ZKM), që do të thotë se të gjitha komunitet¹ në Kosovë duhet t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara për të gjithë qytetarët sipas korniza ligjore nacionale të Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat shtesë që ua mundësojnë atyre ruajtjen e identitetit dhe kulturës së tyre si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqërinë kosovare.

Veçanërisht, programi për Adresimin e Nevojave të Komuniteteve Jo-shumicë (ACN) kërkon mbështetje në zbatimin e kornizës ligjore dhe politike për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në komunat e Kosovës dhe për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike për komunitetet jo-shumicë.

ZÇK/ZKM-ja bën thirrje për projekt propozime nga komunat për zbatimin e projekteve që plotësojnë objektivat e programit të ACN-së.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Nëpërmjet programit të ACN-së, ZÇK/ZKM kërkon mbështetje në zbatimin e kornizës ligjore dhe politike për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në komunat e Kosovës dhe për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike për komunitetet jo-shumicë.

III. PËRSHKRIMI

III.1. REZULTATET E ACN-së

¹ Komunitetet jo-shumicë definoohen si komunitete të cilat numerikisht janë pakicë në nivel komunal.

Kjo ftesë për propozime është dizajnuar që të bëj thirrje për ide të projektit që mbështesin objektivat e ACN-së. Që të konsiderohen për financim, idetë e projektit duhet që detyrimisht të ndihmojnë në arritjen e rezultateve të mëposhtme:

- Angazhimin e përmirësuar ndërmjet autoriteteve komunale dhe komuniteteve në adresimin e një apo më shumë fushave të shqetësimit të komuniteteve;
- Vëmendjen e shtuar rreth çështjeve të ndërlidhura me femrat nga komunitetet (për shembull, shkalla më e lartë e përfshirjes së femrave në arsim, mundësitë e barabarta të femrave në punësim, etj.).

Përveç kësaj, idetë e projektit mund të përfshijnë një ose më shumë nga rezultate e mëposhtme:

- Zbatimin e shtuar të mbrojtës së të drejtave të komunitetet në një apo më shumë fusha, do të thotë, kundër-diskriminimin, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, të drejtat e identitetit, kulturën, religjionin, gjuhën, mediet, qasjen në arsim, mundësitë ekonomike dhe sociale, shëndetësinë, dhe/apo përfaqësimin;
- Zbatimin e shtuar të strategjive dhe veprimeve qeveritare që adresojnë apo ndikojnë tek komunitetet, në veçanti të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe planit të saj të veprimit;
- Ngritjen e kualitetit të jetës të pjesëtarëve më të prekur të komuniteteve jo-shumicë.

III.2. ELEMENTET E ACN-së

Aktivitetet e mundshme të projektit mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- Ngritjen e mekanizmave të qëndrueshëm të angazhimit ndërmjet organizatave nga shoqëria civile e komuniteteve dhe autoriteteve komunale;
- Zhvillimin e infrastrukturës në zonat e banuara nga komunitetet jo-shumicë;
- Mbështetjen për qasjen në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, si dhe ndërveprimin ndërmjet nxënësve dhe studentëve nga komunitetet e ndryshme;
- Ofrimin e qasjes në shërbime publike për komunitetet jo-shumicë;
- Promovimin dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve që zyrtarisht përdoren në nivel komunal;
- Promovimin e identiteteve, kulturës, religjionit dhe gjuhëve të komuniteteve jo-shumicë;
- Zhvillimin e mundësive ekonomike për komunitetet dhe/apo pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë t'ju mundësohet që të identifikojnë dhe zhvillojnë vetë mundësitë për gjenerim të të hyrave;
- Angazhimin e shoqërisë civile, përfaqësuesve të qeverisë komunale, dhe/apo medieve në identifikimin e problemeve specifike të komuniteteve dhe në zhvillimin e propozimeve konkrete vepruese për përmirësimin e gjendjes në nivel lokal;
- Zbatimin e një apo më shumë aktiviteteve të planit të veprimit në Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës;

Projektet që mundësojnë dialogun ndëretnik dhe promovojnë shumë-etninë mund të pranohen si të favorshme.

Përveç aktiviteteve të mësipërme, projektet që përfshijnë rininë, apo që adresojnë çështjet e të rinjve, do të konsiderohen në mënyrë pozitive.

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Zyra e Kryeministrit
Ftesë për Propozime: Programi ACN

Komunat inkurajohen fuqimisht në kërkimin e partneriteteve me organizatat nga shoqëria civile. Lidhja dhe vendosja e partneriteteve nuk duhet të jenë të detyrueshme apo medoemos të nevojshme, por vetëm të inkurajuara ashtu që të mund të ndodhin natyrshëm.

IV. UDHËZIME PËR APLIKANTËT

Në vijim janë udhëzimet e hollësishme për aplikantët e mundshëm.

Cilado pyetje në lidhje me këtë ftesë për propozime duhet të dorëzohet me shkrim me anë të postës elektronike në zck-kpz_grants@ks-gov.net, me temën vijuese “ACN”; apo në adresën e mëposhtme duke shkruar “ACN” mbi zarf:

Zyra për Çështje të Komuniteteve
Zyra e Kryeministrit
Ndërtesa e Qeverisë
Dhoma 606
Rruga Nëna Terezë.
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

IV.1. PRANUESHMËRIA

Të gjitha komunat e Kosovës dhe pjesët përbërëse të tyre janë aplikantë të pranueshëm. Aplikacionet gjithashtu mund të paraqiten në formë të konsociumeve të tyre.

IV.2. AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Aplikacionet mund të dorëzohen në çdo kohë para datës 30 prill 2010.

Përzgjedhja e aplikacioneve do të bëhet brenda katër javësh pas afatit përfundimtar të dorëzimit, që është 30 prill 2010. Një komision i përbërë nga personeli i ZÇK/ZKM-së dhe ekspertët e pavarur do t'i shqyrtojnë të gjitha aplikacionet. Negociatat përfundimtare dhe shpallja e fituesit do të menaxhohen nga ZÇK/ZKM-ja.

ZÇK/ZKM-ja mban të drejtën për shpallje e çfarëdo numri fituesve apo që këtë mos ta bëjë fare. ZÇK/ZKM-ja nuk është përgjegjëse për çfarëdo shpenzimi që ka të bëjë me zhvillimin e projekt propozimeve.

IV.3. FINANCIMI

Shuma totale në dispozicion për këtë ftesë për propozim e cila përfundon 30 prill 2010, është 95,000 Euro. Financimi për një grant individual sipas kësaj ftese për propozim do të sillet prej 5,000 deri 20,000 Euro, dhe periudha maksimale e përmbushjes është 12 muaj. Buxheti duhet të jetë i përgatitur në Euro dhe të jetë i bazuar në aktivitetet e përshkruara në aplikacion.

IV.4. METODAT E DORËZIMIT

Ekzistojnë dy metoda të mundshme të dorëzimit:

1. Aplikacionet mund të dërgohen me anë të postës elektronike në: zck-kpz_grants@ks-gov.net, me titullin vijues “ACN”

2. Aplikacionet mund të dorëzohen me dorë në:

Zyra për Çështje të Komuniteteve
Zyra e Kryeministrit
Ndërtesa e Qeverisë
Dhoma 606
Rruga Nëna Terezë.
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Në rast të dorëzimit në dorë, aplikantët duhet të japin një kopje të shtypur të aplikacionit, si dhe një kopje elektronike në një CD-ROM. Materialet duhet të jenë në një zarf të mbyllur me emrin dhe adresën e aplikantit në qoshen e sipërme të majtë dhe të kenë të vendosur “ACN” në këndin e poshtëm të djathtë.

Aplikantët duhet t’i ruajnë kopjet për të dhënat e tyre, pasi që të gjitha aplikacionet e pranuar nuk do t’u kthehen më.

IV.5. PROCESI I SHQYRTIMIT

Aplikanti do ta paraqes propozimin e plotë dhe buxhetin e hollësishëm deri në afatin e dhënë. ZÇK-ZKM-ja mban të drejtën për të kërkuar ndryshime në përshkrimin e projektit dhe të buxhetit të hollësishëm dhe do t’i ofrojë ndihmë teknike organizatës për t’i inkuorporuar ndryshimet e kërkuara. Pastaj, projekt propozimet e ndryshuara dhe buxheti i hollësishëm do të vlerësohen sipas një vendimi përfundimtar.

IV.5.1. Aplikacioni dhe buxheti i hollësishëm

Partnerët e mundshëm duhet të paraqesin një projekt propozim të plotë dhe buxhetin e hollësishëm duke shfrytëzuar formularët e ZÇK/ZKM duke iu përmbajtur specifikacioneve të mëposhtme.

Aplikantët duhet t’i zhvillojnë idetë për projektin e tyre dhe të hartojnë propozimin e tyre në bazë të kuptimit të nevojave të komuniteteve, duke shfrytëzuar parvojën e tyre paraprake. Aktivitetet duhet të zhvillohen me kujdes, pasi që aplikanti do të jetë përgjegjës për rezultatet specifike dhe financimi i ardhshëm do të varet nga arritja e rezultateve të propozuara.

Aplikacionet duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Aplikacionet duhet të dorëzohen duke shfrytëzuar vetëm formularin e ZÇK/ZKM-së. Aplikacionet e dorëzuar në format tjetër nuk do të merren parasysh. Projekt propozimet e plota duhet t’i adresojnë qartë të gjitha informatat e kërkuara. Projekt propozimet e plota nuk duhet t’i tejkalojnë 15 faqe.

1. Projekt propozimi (formulari i bashkangjitur)

1.1. Informacione themelore

1.2. Përmbledhje e projektit

- Historiku (deklarata e arsyeshmërisë/problemit dhe aktivitetet e jetësuar deri më tash);
- Përmbledhje e objektivave specifike, shtrirjes gjeografike, përfituesve të drejtpërdrejtë, aktiviteteve, rezultateve të pritura, përfshirë treguesit dhe ndikimin afatgjatë;
- Implementimi i projektit, përfshirë partneritetet (nëse ka); dhe

- Shpjegim i shkurtër se si aktivitetet e propozuara kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe rezultateve të përgjithshme të ACN-së.

1.3. Informacione për komunën

- Popullsia nga komunitetet jo-shumicë
- Problemet kryesore më të cilat ballafaqohen komunitetet jo-shumicë në komunë
- Projektet për komunitete të realizuara që nga viti 2008 dhe të planifikuara për vitin 2010
- Informata
- Informacionet rreth buxhetit për projekte për komunitete
- Ekipi i projektit

1.4. Përshkrimi i projektit

- Rëndësia: paraqitja e problemit dhe lidhja me objektivat dhe rezultatet e përgjithshme të ACN-së
- Informacionet për përzgjedhjen e këtij projekti si prioritet dhe përfshirja e komunitetit në zgjedhjen dhe zhvillimin e idesë së projektit
- Objektivat e përgjithshme dhe specifike të projektit juaj

1.5. Aktivitetet dhe rezultatet

1.6. Përfituesit

1.7. Angazhimi i qytetarëve lokalë

- Përfshirja e qytetarëve
- Përfshirja e komuniteteve jo-shumicës

1.8. Dukshmëria e donatorëve (ZÇK/ZKM)

1.9. Qëndrueshmëria: si rezultatet e projektit do të mbahen në afat të gjatë

1.10. Monitorimi dhe Verësimi

1.11. Plani i Veprimit

2. Buxheti i detajuar (formulari i bashkangjitur)

IV.5.2. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret e paraqitura më poshtë janë përcaktuar për nevojat e kësaj ftese për propozim. Numri i përgjithshëm prej 100 pikëve është i mundshëm për aplikim të plotë. Rëndësia përkatëse e çdo kriteri tregohet me anë të rëndësisë së përafërt sipas pikave.

Aplikacionet do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme për vlerësim teknik. Puna do t'i jepet aplikantit të përgjegjshëm aplikacioni i të cilit ofron vlerat më të mira për ZÇK/ZKM. Aplikantët duhet ta kenë parasysh se këto kritere: (1) shërbejnë si standard sipas të cilit të gjitha aplikacionet duhet të vlerësohen, dhe (2) shërbejnë për identifikimin e çështjeve të rëndësishme, të cilat aplikantët duhet t'i adresojnë në aplikacionet e tyre.

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Zyra e Kryeministrit
Ftesë për Propozime: Programi ACN

Aplikacionet do të vlerësohen sipas shkallës prej 100 pikëve, si më poshtë: Kriteret e vlerësimit të aplikacionit	Rëndësia
Komunitetet/ përfituesit e synuar të projektit Dëshmia e lidhjeve me programet jo-shumicë dhe me burimet vendore e institucionale; Dëshmia e pjesëmarrjes e komuniteteve jo shumicë në projektimin, zhvillimin, zbatimin, si dhe mbikëqyrjen dhe vlerësimin e programit; Garancia që femrat dhe të rinjtë do të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga aktivitetet.	25 pikë
Arsyeja/arsyetimi i projektit A është sqaruar dhe arsyetuar mirë formulimi i problemit? A e identifikon iniciativa e propozuar problemin, nevojën apo mundësinë për ta adresuar nëpërmjet projektit?	25 pikë
Dizajni dhe strategjia e projektit A i adreson projekti objektivat dhe rezultatet e pritura të programit të ACN-së? A e ka projekti qëllimin e përgjithshëm të qartë? A ka gjasa që dizajni i projektit të propozuar të arrijë qëllimin dhe rezultatet e përcaktuara? A i ka parasysh dizajni i projektit ndërhyrjet ekzistuese dhe a e sqaron se si do t'i plotësoj ato? A është strategjia e propozuar e realizueshme në lidhje me strukturën organizative dhe kërkesat buxhetore?	20 pikë
Rezultatet e parashikuara të projektit dhe përfitimet A janë rezultatet e pritura të lidhura me synimin e përgjithshëm? A janë artikuluar qartë përfitimet e popullatës së synuar?	10 pikë
Plani i mbikëqyrjes dhe vlerësimit A ka projekti një plan të qartë për t'i matur rezultatet e projektit? A do të kryhet plani i mbikëqyrjes dhe vlerësimit në mënyrë pjesëmarrëse?	5 pikë
Efektshmëria e kostos së buxhetit të propozuar A është buxheti koherent me aktivitetet e propozuara? A është buxheti i favorshëm në çmim? A janë të gjithë artikujt e buxhetit të përshkruar në mënyrë të qartë?	15 pikë
Totali	100 pikë

Një komision i përbërë nga anëtarët e personelit të ZÇK/ZKM-së dhe nga ekspertët e pavarur do të shqyrtoj propozimet sipas përmbushjes së objektivave dhe rezultateve në pajtueshmëri me kriteret e lartpërmendura.

V. KUSHTET

V.1. MARRËVESHJA E GRANTIT

Marrëveshja e grantit do të përfshij përshkrimin e projektit të miratuar, buxhetit të miratuar, kërkesave të raportuara dhe kushteve përkatëse. Më fillimin e zbatimit të saj, kjo marrëveshje do të ketë efekt ligjor për ZÇK/ZKM-në dhe organizatës marrëse. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, ajo nuk mund të ndryshohet pa miratimin paraprak me shkrim nga ZÇK/ZKM.

V.2. LËSHIMI I GRANTIT DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Grantet do të jepen në disa këste, pas miratimit të raporteve periodike dhe përfundimtare. Sasia dhe data në të cilën çdo këst do të jepet do të varet nga aktivitetet e projektit dhe do të fiksohet në marrëveshjen e grantit.

V.3. RAPORTIMI

Marrëveshja e grantit do t'i përcaktojë me hollësi kërkesat për raportim. Marrësit duhet të jenë të gatshëm t'i përmbahen orarit të raportimit dhe kërkesave si për aktivitetet e programit ashtu edhe për mbikëqyrjen financiare.

V.4. MBIKËQYRJA

Stafi i ZÇK/ZKM do të mbikëqyr ecurinë programatike. ZÇK/ZKM mban të drejtën për të rishikuar financat, shpenzimet dhe të gjitha dokumentet përkatëse në çdo kohë gjatë periudhës së projektit dhe për tre vjet pas përfundimit të projektit dhe mbylljes së tij. Të gjitha faturat origjinale duhet të ruhen për tri vite pasi mbyllja zyrtare të jetë kompletuar.

V.5. KUSHTET STANDARDE

Nga ZÇK/ZKM kërkohet që të respektoj dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Kosovës. ACN-ja do të administrohet sipas procedurave të Zyrës së Kryeministrit.

VI. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA

Dokumentet e bashkangjitura në vijim konsiderohen si pjesë e kësaj ftese për propozim. Të gjitha formularët dhe udhëzimet si shtojcat e paraqitura më poshtë mund gjithashtu të pranohen me anë të postës elektronike nga: zck-kpz_grants@ks-gov.net.

1. Formulari i projekt propozimit
2. Formulari i buxhetit të hollësishëm